

PROBLEME TË ZBATIMIT TË METODOLOGJISË SË KËRKIMIT TË SHKENCAVE SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Në fokus rasti i një studimi panel bazuar në sondazhe të opinionit publik për
sjelljen votuese të elektoratit të qytetit të Tiranës. Mars-Prill 2011)

DORINA BËRDUFI; ALEKSANDËR KOCANI
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

AKTET V, 4: 541 - 546, 2012

Kumtesa paraqet rezultatet e disa studimeve empirike sasiore që lidhen me sjelljen votuese të elektoratit të qytetit të Tiranës me fokus kryesisht sondazhet e studimit panel të zhvilluar në Tiranë në Mars – Prill 2011 nga një ekip studimor i Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale, pranë UT. U realizuan tre sondazhe në 21 Mars, 10 Prill dhe 21 Prill. U përdorën pyetësorë relativisht të shkurtër dhe të ndërtuar sipas një logjike të vijimësisë së indikatorëve të sjelljes votuese të elektoratit të qytetit të Tiranës dhe mbledhjes së informacionit të nevojshëm për drejtimin e një fushate elektorale. Metodologjia e studimit është bazuar në një kampionim me bistak, me strate të papeshuara që përmbillet me kuotë sipas grup moshave dhe gjinisë, në mënyrë që të sigurojë anonimatit e respondentëve dhe me të, edhe sinqeritetin e besueshmërinë e përgjigjeve, për shkak të bërjes së pyetjeve delikate.

Kërkesa metodologjike e sigurimit të anonimatit për respondentët kur bëhen pyetje delikat **nuk** është marrë në konsideratë nga një sërë anketimesh dhe sondazhesh, gjë që i çoi ato në parashikime që ishin larg rezultateve të dala nga zgjedhjet e 8 Majit. Nga raportimet e bëra në mediat elektronike rezultoi se ato kanë përdorur variante të kampionimit sistematik, i cili dihet që e bën të identifikueshëm respondentin. Po të merret në konsideratë fakti që pyetësorët e përdorur prej tyre përfshinin edhe pyetje delikate,

një kombinim i tillë çenonte besueshmërinë e rezultateve, për shkak të rritjes së përgjigjeve jo të sinqerta nga respondentët. Ka dalë me matje të shumta që shkalla e mosbesimit që shfaqin respondentët ndaj « Tjetrit » është relativisht e lartë (në marzhet nga 70% – 90%). Për Tiranën ajo kapte vlerën e afro 90% në Janar të 2011. Me një shkallë të tillë të lartë difidence, kur bëhen pyetje delikate (siç janë ato për bindjet politike dhe votimin në shoqërinë aktuale shqiptare) dhe respondentët perceptojnë se janë lehtësisht të identifikueshëm, natyrshëm pritet prej tyre shkallë e lartë e mos sinqeritetit në përgjigjet. Kjo i bën këto përgjigje si pak ose aspak të besueshme. Gjë që çenon drejtpërdrejtë saktësinë e parashikimit të sjelljes votuese të elektoratit në ditën e votimit.

Një vështrim retrospektiv në zgjedhjet e 28 Qershorit të vitit 2009, nxjerr të njëjtat probleme me zbatimin jo korrekt të parimeve metodologjike të kërkimeve sociale në terrenin e shoqërisë aktuale shqiptare. Edhe në anketimet e bëra nga disa kompani private në periudhën para zgjedhjeve, binte në sy mos zbatimi i kërkesës metodologjike të ruajtjes me çdo kusht të anonimatit në rrethanat e bërjes së pyetjeve delikate. Kështu realizuesit e sondazheve nën siglën e Kompanisë Zogby, zbatuan në mënyrë mekanike, shabllone një procedurë metodike të vlefshme në kushtet e një shoqërie perëndimore të emancipuar politikisht (siç është ajo

amerikane), në një shoqëri ende të pa emancipuar politikisht (siç është ajo shqiptare). Më konkretisht ata imituan përdorimin e një kampionimi sistematik, me bërjen e pyetjeve që hetonin bindjet politike të respondentëve. Por, ndërsa në shoqëritë politikisht të emancipuara pyetjet që hetojnë bindjet politike të respondentëve nuk konsiderohen delikate në këto shoqëri. Prandaj, edhe pse të identifikueshëm (nga kampionimi sistematik), respondentët nuk ndjehen të kërcënuar. Në shoqëritë relativisht pak të emancipuara (si ajo e jona), kombinimi i bërjes së pyetjeve që perceptohen si delikate (për bindjet politike) me kampionim që lejon identifikueshmërinë e respondentëve, prodhon ndjenjën e të qenit të kërcënuar dhe, për rrjedhojë, rrit shkallën e mos sinqeritetit në përgjigjet e respondentëve. Kjo e ul në mënyrë drastike besueshmërinë e rezultateve të sondazheve, për arsye të rritjes së gabimit të matjeve si rrjedhojë e gabimit shtesë që vjen nga shtimi artificial i përgjigjeve të pasinqerta. Dhe e gjitha kjo vjen nga që, në këtë rast, nuk është zbatuar kërkesa metodologjike e sigurimit maksimal të mundshëm të anonimatit të respondentëve.

Nga matjet e marzhit të gabimit që vjen si rezultat i mos marrjes në konsideratë të kësaj kërkesë metodologjike, të kryera në Departamentin e Shkencave Politike në UT në këto dy vitet e fundit, ndonëse ato ende nuk janë kolauduar sa duhet, mund të thuhet se ky marzh është i pritshëm që të jetë në atë masë sa të ndikojë në parashikimin e rezultateve të votimeve.

Metodologjia e studimit mbi sjelljen votuese të elektoratit të qytetit të Tiranës në periudhën Mars – Prill 2011

OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Studimi u hartua në mënyrë të tillë që të përfshinte realizimin e tre sondazheve të opinionit publik të bazuar në pyetësorë të shkurtër dhe të realizuar në një periudhë kohore brenda dy muajve, duke përbërë kështu një lloj studimi vertikal panel. Kjo mënyrë e strukturimit të studimit lejonte që të hetohej dinamika e sjelljes votuese të elektoratit të 11 zonave

elektorale të qytetit të Tiranës dhe, në këtë mënyrë, realizohej edhe komponenti horizontal i studimit panel. Kështu që realizohej njëherazi një studim panel sa horizontal, aq edhe vertikal. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj dinamike, ishte e mundur që të parashikoheshin më tej edhe tendencat e përgjithshme, por edhe ecuria e ardhme e indikatorëve kryesorë që përdoren për të përcaktuar sjelljen votuese.

PROCEDIME PRAKTIKE

Studimi në vetvete nuk kishte një karakter shpjegues, duke lënë të kuptohet se ai nuk synonte të testojë empirikisht për të konfirmuar ose për të përgënjeshtuar ndonjë formulim shkencor të tipit të hipotezës¹⁹. Për më tepër, ai nuk synonte as të testojë empirikisht edhe ndonjë supozim. Prandaj, studimi duke mos qenë i linjës së testimeve empirike (të bazuara në një thënie ose hipotezë që më pas i nënshtrohej testeve empirike për konfirmimin ose përgënjeshttrimin e saj)²⁰, ishte më tepër i karakterit përshkruar. Ai synonte paraqitjen e dinamikës së tablosë së përgjithshme të indikatorëve që masin sjelljen votuese në tre momente të caktuara kohore. Referimi ndaj kësaj tabloje dhe dinamikës së saj kohore do të mundësonte parashikimin e ecurive të ndryshimit të vlerave të indikatorëve në fjalë.

Në këtë kuadër, përtej përcaktimit të indikatorëve për të matur sjelljen votuese të pritshme të elektoratit të qytetit të Tiranës, studimi përmbante edhe mundësinë e bërjes së parashikimeve të rezultatit të votimeve të 8 Majit 2011 në qytetin e Tiranës. Kjo, kuptohet, gjithmonë në kuadër të disa marzheve të gabimit që lejon përdorimi i sondazheve të opinionit publik. Ky pikësypnim i paraqitur së fundmi konsiderohet i një rëndësie të lartë jo vetëm në drejtim të realizimit shkencor të punimit, por më tej edhe në kuadër të mbrojtjes së etikës shkencore dhe metodave të kërkimit shkencor si dhe, në veçanti, sondazheve shkencore përballë opinionit publik. Kështu, studimi ishte edhe një

¹⁹ Kocani, A., Metodave të kërkimit sasior në shkencat sociale, UFO Pres, 2009.

²⁰ Kocani, A., Hyrje në Epistemologji, SHBLU, 2008.

mënyrë e mirë për të kontribuar sado pak në reabilitimin e imazhit të sondazheve shkencore të opinionit publik, përkundrajt fushatës absurde të goditjes së vlerës së sondazheve shkencore (për referim: deklaratat mediatike si sondazhet dështuan, shkenca dështoi etj) që shoqëroi konstatimin e mospërrputhjes midis rezultateve të disa sondazheve (problematikë nga pikëpamja e zbatimit korrekt të metodologjisë) dhe atyre të votimeve.

Metodologjia e përdorur në studim i referohet asaj të ndërtimit të sondazheve të shkurtra që përdorin indikatorë specifik në drejtim të matjes së treguesve kryesorë që konturojnë dinamikat e sjelljes votuese të elektoratit të Tiranës. Në këtë drejtim është ndjekur e njëjta metodikë sipas modelit bazë të sondazheve që i shërbejnë fushatave elektorale. Fillimisht bëhet një hetim i "gjeografisë politike" për të përcaktuar ngjyrat ideologjike në të dhënat e strukturuar sipas grupmoshës, gjinisë, shkollimit dhe statusit social, përkundrajt qëndrimit konkret ndaj disa çështjeve themelore të rëndësisë primare për opinionin publik.

Si të tilla u zgjodhën vlerësimi i punës së kandidatëve, vlerësimi i personalitetit të tyre, vlerësimi i punës së deritanishme të bashkisë si dhe vlerësimi i përgjithshëm i punës së qeverisë, pra vlerësimi i maxhorancës qeverisëse. Kjo metodologji e përdorur synon të evidentojë problematikën, të hamendësojë shkaqet e sjelljeve të konstatuara (të grupuara sipas gjinisë, moshës, statusit social etj) e në këtë kontekst të propozojë edhe kundërpërgjigjen përkatëse elektorale (nga ekipet e fushatave elektorale).

Pra, metodologjia, përkundër dhënies së sugjerimeve që do t'i shërbenin secilit ekip elektorale për të korrigjuar fushatën elektorale në drejtime të caktuara, synonte të jepte edhe vlerësime të përafërta të shanseve për fitore të njërit apo tjetrit kandidat.

REZULTATET E STUDIMIT

Në paraqitjen e rezultateve të studimit do të ndiqet linja vertikale kohore e zhvillimit të secilit prej sondazheve. Në këtë kuadër do të analizohen të dhënat e përgjithshme të sondazhit

të parë duke nisur që me të dhënë më domethënëse që është Indikatori i Mirëqenies Subjektive (IMS)²¹. Ashtu siç dihet, Indikatori i Mirëqenies Subjektive (këtu e në vijim IMS) është një indikator që shpreh dhe mat shkallën e legjitimitetit që i japin respondentët institucioneve demokratike²².

Indikatori është përcaktuar fillimisht nga studiuesi i mirënjohur në fushën e studimit të vlerave, Ronald Inglehart, i cili është veçanërisht i vlerësuar për kontributin e tij që prej viteve 70' për studimin e të ashtuquajturit "*revolucion të heshtur*" dhe ndryshimin e orientimit të përgjithshëm të vlerave në shoqëritë bashkëkohore.

IMS-ja ka si strukturë bazë diferencat në shkallën e lumturisë (nga qëndrimet shumë dhe mjaft i lumtur hiqen ato pak dhe aspak i lumtur) dhe diferencat e shkallës së kënaqësisë (njësoj si për lumturinë, edhe në këtë rast nga qëndrimet shumë dhe mjaft i kënaqur hiqen ato pak dhe aspak i kënaqur). Formula e saj është: $IMS = [\Delta(\text{lumturia}) + \Delta(\text{kënaqësia})] / 2$ ku $\Delta(\text{lumturia}) = [\text{shumë} + \text{mjaft i lumtur}] - [\text{aspak} + \text{pak i lumtur}]$, kurse $\Delta(\text{kënaqësia})$ nga jeta = $[\text{shumë} + \text{mjaft i kënaqur nga jeta}] - [\text{aspak} + \text{pak i kënaqur nga jeta}]$.

Nëse e aplikojmë këtë formulë dhe gjejmë IMS-në për të gjithë elektoratin e qytetit të Tiranës, në sondazhin e parë të datës 13 Mars 2011, do të shohim që:

- a) $\Delta(\text{lumturia}) = 52.1\% - 22.6\% = +29.5\%$;
- b) $\Delta(\text{kënaqësia}) = 50.3\% - 25.6\% = +24.7\%$; e për pasojë
- c) $IMS = [\Delta(\text{lumturia}) + \Delta(\text{kënaqësia})] / 2 = [(+29.5\%) + (+24.7\%)] / 2 = +27.1\%$

IMS-ja e përlogaritur për sondazhin e parë jep një rezultat pozitiv, çka do të thotë se respondentët i legjitimojnë institucionet demokratike. Pra, rezultati **+27.1%** është tregues

²¹ Inglehart, R., «Globalization and Postmodern Values», *Washington Quarterly*, 23.1 (2000).

²² Inglehart, R., Baker, W.E., *Modernization, cultural change, and the persistence of traditional values*, *American Sociological Review*, 2000, Vol. 65 (February: 27).

i pranisë së një shkalle të lartë të legjitimitimit politik. Për të konfirmuar praninë e lartë të legjitimitimit politik do të shihet raporti në lidhje me *vlerësimin e suksesit të qeverisë, vlerësimin e mundësisë së rotacionit të pushtetit qendror dhe vlerësimin e punës së bashkisë*. Nëse IMS-ja merret e mirëqenë, logjikisht presim që të ketë një korrelim mes tre indikatorëve që do të konfirmojnë ose jo rezultatin e IMS-së.

Indikatori	Vlerësimi
IMS	+ 27.1 %
Suksesi i Qeverisë	1 : 1.46 (Vlerësimi "-")
Rotacioni i madh (pushtet qendror)	1 : 1.32 (Vlerësimi "-")
z. Edi Rama	1 : 1.38 (Vlerësimi "+")
z. Lulzim Basha	1 : 1.15 (Vlerësimi "-")
Vlerësimi i punës së Bashkisë	1 : 1.78 (Vlerësimi "+")
Rotacioni i vogël (pushteti lokal)	1 : 1.29 (Vlerësimi "-")

Pra, si përfundim, mund të themi se rezultati pozitiv dhe mjaft i lartë i IMS-së është plotësisht i legjitimuar. Ashtu siç edhe mund të pritej, respondentët nuk e vlerësojnë maksimalisht performancën e deritanishme të qeverisë, por ata nuk janë për *ndryshimin e pushtetit (pra rotacionin e madh)*. Mesazhi është që qeveria qendrore duhet të *përmirësojë vazhdueshëm punën e saj*.

Gjithashtu, të dhënat për vlerësimin e pushtetit vendor tregojnë se puna e bashkisë vlerësohet pozitivisht, gjë që legjitimon *nivelin relativisht të lartë të IMS-së*. Por, meqenëse kryetari vlerësohej pozitivisht **1.29** herë më pak se sa puna e bashkisë, kjo tregon se kërkohet një përmirësim në punën e Kryetarit të Bashkisë. Kjo mbështetet edhe në të dhënat mbi rotacionin e bashkisë: respondentët janë kundër ndryshimit të kahut qeverisë në pushtetin lokal (pra kundër marrjes së bashkisë nga e djathta).

Nëse e aplikojmë formulën përkatëse dhe gjejmë IMS-në për të gjithë elektoratin e qytetit të Tiranës, në sondazhin e dytë të datës 10 Prill 2011, do të shohim që:

$$27.1\% - 25.8\% = +1.3\% \Delta \text{ (lumturia)}$$

$$32.9\% - 27.3\% = + 5.6\% \Delta \text{ (kënaqësia)}$$

$$\text{IMS} = [\Delta(\text{lumturia}) + \Delta(\text{kënaqësia})] / 2 = [(+1.3\%) + (+5.6\%)] / 2 = \mathbf{+3.45\%}$$

Shihet se vlera e IMS në sondazhin e dytë ka pësuar një rënie drastike prej afro **8** herësh. Formalisht kjo rënie mund të interpretohet si një ulje e legjitimitetit që i japin institucioneve respondentët nga gjiri i elektoratit të qytetit të Tiranës në fillim të muajit Prill 2011. Në mbështetje dhe ballafaqim me këtë indikator po sjellim tabelën ku janë paraqitur edhe indikatorët e tjerë, të cilët lejojnë të interpretohet më në hollësi ulja e IMS.

Indikatori	Vlerësimi
IMS	+ 3.45 %
Drejtimi i Bashkisë PD + aleatët e saj	1 : 1.2 (Vlerësimi "-")
Ndryshimi i thellë nga PS + aleatët e saj	1 : 1.09 (Vlerësimi "+")
Vlerësimi i punës së Bashkisë	1 : 2.44 (Vlerësimi "+")
z. Edi Rama	1 : 1.41 (Vlerësimi "+")
z. Lulzim Basha	1 : 1.29 (Vlerësimi "-")

IMS-ja e sondazhit të dytë tregon për një legjitimim të institucioneve të pushtetit lokal. Vlerësimi ndaj tyre është pozitiv. Prandaj, nuk kërkohet një ndryshim politik në favor të marrjes së drejtimit të Bashkisë nga e djathta shqiptare. Por, respondentët mbështesin më tepër mendimin se *ndryshimin e thellë që kërkon sot puna në Bashki mund ta kryejnë vetë partitë e krahut të majtë*. Pra, legjitimohet drejtimi i Bashkisë nga e majta shqiptare. Këtë gjë e konfirmon edhe vlerësimi pozitiv për punën e deritanishme të Bashkisë.

Por, vërehet se puna e bashkisë vlerësohet më tepër pozitivisht se ajo e kandidatit. Duke qenë se bashkia vlerësohet pozitivisht **2.44** herë më tepër

se vlerësimi negativ, dhe kandidati E.Rama vlerësohet pozitivisht **1.32** herë më tepër sesa vlerësimi negativ, mund të thuhet se rënia në IMS gjatë sondazhit të dytë ka ardhur si pasojë e faktit se dëshirohet një rotacion në drejtimin e bashkisë së kryeqytetit. Kështu që legjitimohet drejtimi i Bashkisë nga e majta, por meqenëse vlerësimi pozitiv për kryetarin e Bashkisë është më i ulët se vlerësimi pozitiv për punën e Bashkisë, mund të thuhet se është më i nevojshëm një ndryshim për kryetarin e Bashkisë së Tiranës **sesa** për forcën politike që e drejton atë.

Nëse e aplikojmë formulën përkatëse dhe gjejmë IMS-në për të gjithë elektoratin e qytetit të Tiranës, në sondazhin e tretë të datës 21 Prill 2011, do të shohim që:

$\Delta(\text{lumturia}): 21.6\% - 26.8\% = -5.2\%$

$\Delta(\text{kënaqësia}): 30.9\% - 28.5\% = +2.4\%$

$\text{IMS} = [\Delta(\text{lumturia}) + \Delta(\text{kënaqësia})] / 2 = [(-5.2\%) + (+2.4\%)] / 2 = -1.4\%$

IMS është **-1.4%**.

Vazhdon ulja e këtij indikator i që tregon për rënien e legjitimitetit që u japin respondentët nga elektorati i qytetit të Tiranës institucioneve demokratike. Për të kuptuar se kujt i "faturuhet" kjo ulje, po paraqesim tabelën me indikatorët e tjerë që lejojnë të detajohet e interpretohet ulja në fjalë.

Ndërsa në kalimin nga sondazhi i parë (S1) tek sondazhi i dytë (S2) vërehej një ulje në shkallën e legjitimitetit të institucioneve demokratike, përllogaritja e IMS-së për sondazhin e tretë të çon në një delegitimim të institucioneve politike në vlerën e "**- 1.4%**". Kështu rezultatet e IMS-së së sondazhit të tretë (S3) pohojnë se ka një mungesë të dukshme të legjitimitetit të institucioneve demokratike.

Nëse e marrim si të mirëqenë këtë shifër dhe këtë raport, pra nëse nuk janë bërë gabime gjatë plotësimit të pyetësorëve, atëherë është e drejtë të komentohet kjo rënie e IMS-së *si shfaqje të delegjimitetit që i jep elektorati i qytetit të Tiranës, institucioneve politike*. Pra, ka një ulje që, nëse do të merret e mirëqenë, tregon për një rënie të legjitimitetit që i jep elektorati i qytetit të

Tiranës institucioneve demokratike. Çështja që shtrohet në këtë rast është nëse kjo rënie e legjitimitetit i atribuohet pushtetit qendror, atij lokal apo të dyjave bashkë. Për këtë lypset të shikohet raporti në lidhje me *vlerësimin e mundësisë së rotacionit vogël të pushtetit lokal dhe vlerësimin e punës së bashkisë*. Shihet se në sondazhin e tretë përmbysset konsiderata e mëparshme që bashkinë ta mbajnë forcat e majta. Tashmë këtë mundësi e vlerësojnë negativisht **1.3** herë më shumë se sa pozitivisht. Po ashtu është rritur kundrejt sondazhit të dytë me afro **1.26** herë vlerësimi pozitiv se *bashkinë duhet ta marrin forcat e djathta*.

Indikator	Vlerësimi
IMS	-1.4%.
Drejtimi i Bashkisë PD + aleatët e saj	1 : 1.05 (Vlerësimi "+")
Gjëja më e mirë është që ta mbajnë bashkinë ata që e kanë	1 : 1.3 (Vlerësimi "-")
Vlerësimi i punës së Bashkisë	1 : 2.41 (Vlerësimi "+")
z. Edi Rama	1 : 1.37 (Vlerësimi "+") S.3 : S.2= 1.09 S.3 : S.1 = 1.04
z. Lulzim Basha	1 : 1.41 (Vlerësimi "+") S.3 : S.2= 2.49 S.3 : S.1 = 1.65

Në vlerësimet ndaj kandidatëve për kryetar bashkie, bie në sy se në sondazhin e tretë vlerësimi për z.L.Basha përmbysset në raport me dy sondazhet e para. Për herë të parë për të vlerësimi pozitiv është më i lartë se sa ai negative, madje në një nivel të dukshëm (**S.3 : S.2= 2.49**). Edhe kundrejt sondazhit të parë rritja është e dukshme. Mund të flitet për një tendencë rritjeje të konsiderueshme, sidomos po të krahasohet me tendencën e dobët rritëse për z.E.Rama (**S.3 : S.2= 1.09**), e cila është **2.28** herë më e ulët se sa ajo për z.L.Basha.

Një diferencë e tillë e dukshme në tendencat rritëse në vlerësimin pozitiv të dy kandidatëve, në kushtet kur vlerësimet pozitive të tyre në sondazhin e tretë dallohen me një shifër

relativisht të vogël, e cila futet Brenda gabimit të matjes, të bën të supozosh një fitore të mundshme të z.L.Basha, por me një rezultat të ngushtë²³.

BURIMET

1. Inglehart, R., *Globalization and Postmodern Values, Washington Quarterly*, 23.1 (2000).
2. Inglehart, R., Baker, W.E., *Modernization, cultural change, and the persistence of traditional values, American Sociological Review*, 2000, Vol. 65 (February: 27).
3. Kocani, A., *Metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale*, UFO Pres, 2009.
1. Kocani, A., *Hyrje në Epistemologji*, SHBLU, 2008..

²³ Një supozim i tillë u është deklaruar në fund të muajit Prill 2011 rreth 100 studentëve të vitit të dytë të Shkencave Politike pranë UT dhe ai u konfirmua nga rezultatet e votimit të 8 Majit 2011.